



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“TEKNOLOGJIA E PËRPUNIMIT TË PLASTIKËS DHE GOMËS”

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK²

Q3-III-16

Tiranë, Shtator 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Teknologjia e përpunimit të plastikës dhe gomës”			Kodi Q3-III-16
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Teknologjia e përpunimit të plastikës dhe gomës” , niveli III-të i KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për këtë industri, si dhe të zhvillojë aftësitë e individit për t’iu përshtatur shoqërisë nëpërmjet punës, me formimin e tij.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Teknologjia e përpunimit të plastikës dhe gomës” të nivelit të tretë në KSHK, referuar niveli III të KEK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë përfunduar kualifikimin profesional, “Teknologji kimike”, niveli II në KSHK referuar niveli II të KEK; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të kualifikimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Teknologjia e përpunimit të plastikës dhe gomës”, niveli III-të në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe suplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë.</p> <p>Me arsimim të mëtejshëm, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin teknik/menaxher, në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, dhe ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës, si punonjës i kualifikuar, në ndërmarrje të ndryshme të industrisë kimike, për prodhimin dhe përpunimin e plastikës, gomës, si dhe riciklimin pas përdorimit të tyre. Gjithashtu, ai/ajo mund të punojë, si punonjës i kualifikuar në sipërmarrje për prodhimin dhe përpunimin, riciklimin dhe tregtimin e plastikës dhe gomës.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë rregullat e sigurimit në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e sigurimit teknik në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe të riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të shpjegojë detyrat dhe përgjegjësitë, lidhur me sigurinë vetjake e kolektive, sigurinë në vendin e punës;
- Të shpjegojë veçoritë e dokumentacionit të shkruar dhe të miratuar për çdo vend pune, të sigurimit teknik, të mbrojtjes ndaj pluhurave, gazit dhe zjarrit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse, të aparaturave të sigurisë dhe të shpëtimit në rast aksidenti në punë;
- Të shpjegojë rastet e mundshme të aksidenteve apo helmimeve gjatë punës dhe mënyrat e parandalimit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidentesh apo helmimesh në punë;
- Të shpjegojë rregullat kryesore për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, gazi dhe pluhurat gjatë prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të listojë mjetet e mbrojtjes individuale dhe kolektive kundër zjarrit, gazit dhe pluhurave në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të listojë mjetet kryesore zjarfikëse që përdoren në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave, duke shpjeguar përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të mjeteve të mbrojtjes individuale dhe kolektive kundër zjarrit, gazit dhe pluhurave në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave ;
- Të shpjegojë skemat kryesore stacionare dhe të lëvizshme të mbrojtjes kundër zjarrit në fabrikat dhe impiantet teknologjike gjatë proceseve të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave ;
- Të shpjegojë rregullat e sigurimit në punë gjatë shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe shërbimeve/remonteve të aparaturave, makinerive, pajisjeve, linjave, armaturave dhe impianteve të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave ;
- Të përshkruajë normat e higjienës vetjake e kolektive, të vendit të punës dhe të ambienteve të prodhimit;
- Të shpjegojë kërkesat kryesore teknike dhe higjieno-sanitare gjatë transportimit, depozitimit, ruajtjes dhe përpunimit të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse;

- Të shpjegojë kërkesat kryesore teknike dhe higjieno-sanitare gjatë transportimit, depozitimit, ruajtjes, paketimit dhe tregtimit të produkteve të gatshme;
- Të shpjegojë kërkesat kryesore teknike dhe higjieno-sanitare gjatë transportimit, depozitimit, ruajtjes dhe përdorimit të kimikateve dhe lëndëve me rrezikshmëri të lartë zjarri, eksplozioni dhe helmimi;
- Të shpjegojë skemat e evakuimit në raste emergjence apo rreziku në fabrikat dhe impiantet teknologjike të proceseve prodhimit, të përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përshkruajë skemat e hermetizimit të mjedisëve, pajisjeve dhe linjave teknologjike për parandalimin dhe mbrojtjen e tyre nga eksplozionet;
- Të përshkruajë ndikimet mjedisore të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të listojë ndotësit kryesorë të ngurtë, të lëngët, dhe të gaztë të formuara nga proceset fiziko-kimikë dhe teknologjikë të përgatitjes së lëndëve të para dhe ndihmëse, gjatë prodhimit, përpunimit, riciklimit, ruajtjes dhe transportit të plastikës dhe gomave, si dhe ndikimin e tyre në mjedis;
- Të përshkruajë shkallën e rrezikshmërisë të ndotësve për njerëzit, kafshët dhe bimët, që gjenerohen nga industria e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të shpjegojë masat kryesore për minimizimin dhe reduktimin e mbetjeve në mjedis nga proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përshkruajë mënyrat e grumbullimit, ambalazhimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve të proceseve të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përshkruajë simbolet e sigurisë për lëndët e para, ndihmëse dhe produktet përfundimtare (prej gome dhe plastike);

Njohuri të përgjithshme në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës

- Të përshkruajë kalandrat, ekstruder, presa, injektorë të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë ciklonët, filtrat, aspiratorët, kompresorët, pompat, si dhe platformën e transportimit dhe ambalazhimit, të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e linjave dhe armaturave (ventila, saraçineska, valvola moskthimi, valvola frymëmarrjeje dhe valvola shkarkimi) të përdorura në proceset e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë proceset e përgatitjes së lëndëve të para dhe atyre ndihmëse (shtesa, ujë, kimikate, etj.) për teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në proceset e prodhimit, përpunimit, riciklimit, ambalazhimit dhe të ruajtjes të plastikës dhe gomave;
- Të përshkruajë kartën teknologjike të proceseve të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;

- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të parametrave të punës që ndikojnë në proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit cilësor të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme gjatë proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të shpjegojë funksionimin e aparateve të matjes dhe të kontrollit të parametrave të punës gjatë proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë parimet e punës të aparateve për pastrimin e gazeve dhe ajrit nga pluhurat, bloza dhe avujt toksikë (tretësa organikë, sqfuri, kimikate, lëndët avulluese, etj.);
- Të përshkruajë bilancin material të proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë veçoritë kryesore të përgatitjes së “masës punuese” në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë recepturat e lëndëve të para dhe shtesave në proceset e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë procesin e copëtimit, thërrmimit dhe bluarjes së materialeve të ngurtë (të plastikës dhe gomës);
- Të përshkruajë rolin e thërrmimit dhe imtësisë së bluarjes së lëndëve të para dhe atyre ndihmëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë kërkesat kryesore teknike dhe teknologjike për sigurimin, transportimin, depozitimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve të para, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të listojë mjetet, pajisjet, makineritë, linjat teknologjike, armaturat dhe aparaturat e infrastrukturës të transportit, depozitimit, ruajtjes, tregimit të gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të shpjegojë rolin e ambalazheve dhe etiketimit në industrinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të shpjegojë kuptimin dhe përdorimin e njësive matëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të listojë treguesit cilësorë dhe aparatet për përcaktimin e tyre në lëndët e para, lëndët ndihmëse, në gjysmë produktet dhe produktet e gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të listojë standardet kryesore për treguesit cilësorë të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë masat kryesore për të parandaluar, mbrojtur dhe luftuar korrozionin në pajisjet, makineritë, linjat dhe aparaturat në proceset e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të listojë shkaqet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në prishjen e cilësisë, gjatë prodhimit, përpunimit, riciklimit, transportimit, depozitimit dhe ruajtjes së produkteve të gatshme;
- Të përshkruajë humbjet, faktorët dhe masat për minimizimin e tyre gjatë proceseve të prodhimit, përpunimit, riciklimit, transportimit, depozitimit, ruajtjes, tregimit dhe

- përdorimit të lëndëve të para, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë defektet dhe anomalitë kryesore të mundshme që mund të ndodhin në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të listojë masat për parandalimin dhe eliminimin e defekteve dhe avarive kryesore në proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit;
 - Të përshkruajë simbolet për leximin e skemave të proceseve të prodhimit, përpunimit /riciklimit;
 - Të përshkruajë skica dhe vizatime të thjeshta të prodhimeve nga teknologjia e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave ;
 - Të listojë llojet matjeve të produkteve të fituara të plastikës dhe gomës;
-
- Të shpjegojë rolin e përdorimit të ujit industrial në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të përshkruajë treguesit kryesor të ujit që përdoret në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të përshkruajë mënyrat e trajtimit të ujërave në përshtatje me kërkesat e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të përshkruajë pajisjet, aparaturat dhe skemat teknologjike kryesore të trajtimit të ujit për teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Prodhimi, përpunimi dhe riciklimi i gomave
-
- Të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimin e kauçukut, si dhe llojet e tij, si lëndë e parë (kauçuku natyral-lateksi dhe kauçuku sintetik), në industrinë e gomës;
 - Të përshkruajë mënyrat e identifikimit të kauçukut, nxjerrjen dhe përpunimin e tij nga lateksi;
 - Të përshkruajë mënyrat e përfitimit të kauçukut natyral dhe sintetik;
 - Të përshkruajë vetitë fizike - kimike dhe mekanike të kauçukut;
 - Të klasifikojë lëndët ndihmëse të gomës, vetitë dhe përdorimin e tyre në prodhimtarinë e gomës;
 - Të përshkruajë vetitë dhe karakteristikat e lëndëve ndihmëse (vullkanizuese, shpejtuese, aktivizuese, frenuese, mbushëse, pigmentet, zbutëse, kundër vjetërimit, speciale, etj.), si dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në industrinë e gomës;
 - Të përshkruajë parimin dhe rëndësinë e regjenerimit;
 - Të përshkruajë vartësinë e plasticitetit nga temperatura;
 - Të përshkruajë proceset e regjenerimit të gomës së vjetër me kauçuk natyral;
 - Të përshkruajë procesin e prodhimit të regjeneratës me metoda kimike, me avull dhe mekanike;
 - Të përshkruajë procesin e përpunimit, homogjenizimit dhe rafinimit të regjeneratës;
 - Të përshkruajë llojet e tekstileve, rëndësinë dhe përdorimin e tyre në industrinë e gomës;

- Të përshkruajë recepturat e lëndëve të para, ndihmëse dhe adezivëve për prodhimin e brumit, sipas llojit të gomës;
- Të përshkruajë stadet e proceseve teknologjike kryesore të përgatitjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e gomave;
- Të përshkruajë procesin teknologjik të përzierjes së kauçukut dhe lëndëve të para të gomës;
- Të përshkruajë procesin teknologjik të përpunimit të brumërave të gomës dhe tekstileve për prodhimin e gjysmë produkteve të gomës;
- Të përshkruajë procesin e vullkanizimit të gomës, si dhe ndryshimin e vetive fiziko-kimike dhe mekanike, gjatë këtij procesit;
- Të përshkruajë metodat e vullkanizimit me ajër të nxehtë dhe avull, me rrjedhje dhe formësim me presim me rrjedhje, transferues dhe me injektim;
- Të përshkruajë funksionimin e presave hidraulike për ruajtjen e parametrave standarde, gjatë procesit të vullkanizimit;
- Të listojë llojet e gomave dhe fushat e përdorimit të tyre;
- Të listojë metodat e prodhimit të artikujve prej gome (derdhje- me presim, transferim dhe injektim, ekstradim, kalandrim, veshje dhe shkumim);
- Të përshkruajë parametrat e punës (temperatura, shtypja etj.) gjatë proceseve teknologjike për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e gomave;
- Të listojë karakteristikat cilësore fiziko-kimike dhe fiziko-mekanike të gomës dhe artikujve të saj;

Riciklimi i gomave të përdorura

- Të listojë burimet e mbetjeve të gomave të përdorura dhe karakteristikat për riciklim;
- Të listojë metodat e trajtimit (riciklimit-riveshje, incinerimit, pirolizës, bluarje etj.) të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të riciklimit (riveshjes) të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të incinerimit të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të pirolizës të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë fazat e procesit të riciklimit (riveshjes) dhe të grimcimit të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë proceset e grimcimit mekanik, hidraulik me ujë me presion dhe me sitë në temperatura të larta, të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë procesin e grumbullimit dhe seleksionimit të gomave të përdorura;
- Të përshkruajë procesin e copëtimit dhe thërrmimit të gomave të përdorura për shtresë për rrugica dhe asfalt gome;
- Të përshkruajë procesin e shformësimit të gomave të përdorura;
- Prodhimi, përpunimi dhe riciklimi i masave plastike
- Të klasifikojë lëndët e para dhe lëndëve ndihmëse për prodhimin e masave plastike;

- Të përshkruajë vetitë dhe karakteristikat e lëndëve ndihmëse (zbutëse, mbushëse, stabilizuese, ngjyruese, për pigmente, për lubrifikim, etj.), si dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në industrinë e plastikës;
- Të përshkruajë recepturat e lëndëve të para, ndihmëse dhe adezivëve për prodhimin e brumit, sipas llojit të masave plastike;
- Të listojë llojet e makinerive, aparateve dhe pajisjeve kryesore për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e masave plastike, duke shpjeguar funksionin e tyre;
- Të përshkruajë stadet e proceseve teknologjike kryesore të përgatitjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e masave plastike;
- Të përshkruajë rëndësinë e operacioneve ndihmëse të përpunimit të lëndëve të para të masave plastike;
- Të përshkruajë procesin teknologjik të copëtimit, thërrmimit, granulimit, përzierjes dhe presimit;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të lëndëve të para për prodhimin e masave plastike me derdhje, me presim, me injektim, me tërheqje ose ekstrudim, me petëzim (laminim), kalandrim, me veshje;
- Të përshkruajë parametrat e punës (temperatura, shtypja etj.) gjatë proceseve teknologjike për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e plastikës;
- Të listojë karakteristikat cilësore fiziko-kimike dhe fiziko-mekanike të plastikës dhe artikujve të saj;
- Të përshkruajë mënyrat e përcaktimit të tregueseve cilësor të plastikës dhe artikujve të saj;
- Të përshkruajë matjen dhe shënimin e sipërfaqes së masave plastike me anë të veglave ose shablloneve;
- Të përshkruajë veprimet kryesore për përpunimin mekanik të masave plastike;
- Të klasifikojë veglat e punës për përpunimin e sipërfaqeve të masave plastike;
- Të shpjegojë procesin e sharrimit, shpimit, lëmimit, grirjes të masave plastike;
- Të listojë llojet e presave për përpunimin e masave plastike;
- Të përshkruajë spërkatjen dhe llojet e spërkatësve për përpunimin e masave plastike;
- Të përshkruajë mënyrat e staxhionimit të materialeve plastike në hapësirën e depos;
- Të listojë llojet e veglave dhe pajimeve teknologjike për përpunimin e masave plastike.

Trajtimi i mbetjeve plastike

- Të listojë burimet e mbetjeve plastike dhe karakteristikat për ripërdorim;
- Të përshkruajë teknikat e identifikimit të materialeve plastike në mbetje;
- Të përshkruajë metodat dhe teknikat e identifikimit të llojeve të materialeve plastike në përzierje;
- Të listojë metodat e trajtimit të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të riciklimit dhe të ripërdorimit të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë proceset teknologjike të përpunimit kimikë (piroliza, hidrogjenim, gazifikim dhe djegie) të mbetjeve plastike;

- Të listojë pajisjet, makineritë, aparatet e matjes dhe kontrollit, linjat dhe armaturat sipas metodave të përpunimit të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë hapat e procesit të riciklimit të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë procesin e grumbullimit, seleksionimit, copëtimit, larjes dhe tharjes të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë procesin e shkrirjes (makina shkrirëse) dhe granulimit të mbetjeve plastike;
- Të përshkruajë procesin e shkrirjes (Eskruderë) për kalim nga lëndë e parë (granulat) në stampa të formave të ndryshme, sipas llojit të artikullit të kërkuar;
- Të përshkruajë procesin e stampimit, shënjimit dhe prerjes të produkteve të stampuara të plastikës së ricikluar;

Makinat aparatet dhe pajisjet në teknologjinë e plastikës dhe gomës

- Të listojë makinat kryesore, aparatet, pajimet dhe veglat e punës në repartet e prodhimit të gomës dhe përpunimin e masave plastike;
- Të përshkruajë transportin e fluideve dhe llojet e makinerive të transportimit të tyre (pompave, kompresorëve, ventilatorëve);
- Të përshkruajë transportin e materialeve të ngurta me transportier të llojeve të ndryshme (shirita transportues, makina pneumatike, elevator , konvejer);
- Të përshkruajë proceset e bluarjes dhe tharjes së materialeve të ngurta;
- Të përshkruajë funksionimin e përzierësve (mikserë, kalandrave) për prodhimin e plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë procesin e tharjes së gjysmë produkteve të plastikës dhe gomës;
- Të klasifikojë llojet e makinave për thërrmimin dhe granulimin e materialeve të ngurta (kauçukut, granulave plastike, etj.);
- Të përshkruajë funksionimin e kalandrave për nxjerrjen e shtresave të plastikës dhe gomës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe funksionimin e spërkatësve;
- Të përshkruajë funksionimin e makinave të konfeksionimit të gjysmë produkteve;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe funksionimin e makinave vullkanizuese;
- Të përshkruajë presat (presa hidraulike, rrotulluese) dhe karakteristikat e tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe karakteristikat e eskruderit;
- Të përshkruajë makinat për prodhimin e gypave dhe rripave të transmisionit nga plastika dhe goma;
- Të shpjegojë funksionimin dhe përdorimin e autoklavave, rezervuarëve të ujit kaldajave për prodhimin e avullit;
- Të përshkruajë mjediset dhe makinat tharëse sipas ndërtimit dhe funksionimit;
- Të përshkruajë procesin e tharjes së pëlhurave teknike;
- Të përshkruajë rëndësinë e instrumenteve matëse të temperaturës, shtypjes dhe kohës gjatë procesit të tharjes, së gjysmë prodhimeve të plastikës dhe gomës;

- Të shpjegojë masat mbrojtëse gjatë punës me makina dhe aparate për prodhimin e gjysmë prodhimeve të plastikës dhe gomës;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë detyrat dhe përgjegjësitë, lidhur me sigurinë vetjake e kolektive dhe sigurinë e vendit të punës;
- Të interpretojë veçoritë e dokumentacionit të shkruar dhe të miratuar për çdo vend pune, të sigurimit teknik, të mbrojtjes ndaj pluhurave, gazit dhe zjarrit;
- Të përdorë mjetet mbrojtëse, aparaturat e sigurisë dhe të shpëtimit në rast aksidenti në punë;
- Të evidentojë rastet e mundshme të aksidenteve apo helmimeve gjatë punës dhe mënyrat e parandalimit të tyre;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidentesh apo helmimesh në punë;
- Të zbatojë rregullat kryesore për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri, gazi dhe pluhurat gjatë prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale e kolektive kundër zjarrit, gazit dhe pluhurave në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përdorë mjetet kryesore zjarrfikëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave, duke shpjeguar përdorimin e tyre;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit në punë gjatë shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe shërbimeve/remonteve të aparaturave, makinerive, pajisjeve, linjave, armaturave dhe impianteve të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të zbatojë rregullat e higjienës vetjake e kolektive dhe higjienës së vendit të punës, të ambienteve të prodhimit, transportimit, depozitimit, ruajtjes dhe përpunimit të lëndëve të para dhe atyre ndihmëse;
- Të zbatojë kërkesat kryesore teknike dhe higjieno-sanitare gjatë transportimit, depozitimit, ruajtjes, eksplozionit, helmimit dhe përdorimit të kimikateve dhe lëndëve me rrezikshmëri të lartë zjarri;
- Të përdorë skemat e evakuimit në raste emergjence apo rreziku në fabrikat dhe impiantet teknologjike të proceseve prodhimit, të përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përdorë skemat e hermetizimit të mjedisëve, pajisjeve dhe linjave teknologjike për parandalimin dhe mbrojtjen e tyre nga eksplozionet;
- Të interpretojë shkallën e rrezikshmërisë të ndotësve të ngurtë, të lëngët, dhe të gaztë të formuara nga proceset fiziko-kimikë dhe teknologjikë për njerëzit, kafshët dhe bimët, që gjenerohen nga industria e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;

- Të zbatojë masat kryesore për minimizimin dhe reduktimin e mbetjeve në mjedis nga proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të gomave dhe plastikës;
- Të kryejë grumbullimin, ambalazhimin, transportimin dhe trajtimin e mbetjeve të proceseve të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
- Të përdorë simbolet e sigurisë për lëndët e para, ndihmëse dhe produktet përfundimtare (prej plastike dhe gome);

Njohuri të përgjithshme në fushën profesionale

- Të identifikojë llojet e plastikës dhe gomës sipas fushave të përdorimit të tyre;
- Të dallojë produktet prej plastike dhe gome sipas karakteristikave dalluese;
- Të përzgjedhë lëndët e para (natyrore/sintetike) dhe ndihmëse për teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të krahasojë vetitë fiziko-kimike kryesore të lëndëve të para (natyrore/sintetike), të lëndëve ndihmëse dhe produkteve të teknologjisë të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës” me standardin përkatës;
- Të përdorë dokumentacionin tekniko-teknologjik të regjistrimit me karakteristikat e lëndëve të para, lëndëve ndihmëse dhe produkteve të plastikës dhe gomës;
- Të realizojë proceset parapërgatitore të lëndëve të para dhe ndihmëse në repart;
- Të realizojë proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të zbatojë skemat teknologjike të proceseve të transportimit, depozitimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve të para, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë pajisjet, makineritë, aparatet e matjes dhe kontrollit të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës”;
- Të dallojë tipet e makinerive të copëtimit, thërrmimit dhe të blojës të lëndëve të para dhe ndihmëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë tipet e transportierëve të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse dhe produkteve të gatshme në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë llojet e përzierësve, homogjenizuesve, centrifugave, rezervuarëve dhe dekantorëve në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë kalandrat, ekstruder, presa, injektor të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë ciklonët, filtrat, aspiratorët, kompresorët, pompat, platformën e transportimit dhe ambalazhimit, të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë llojet e linjave dhe armaturave (ventila, saraçineska, valvola moskthimi, valvola frymëmarrjeje dhe valvola shkarkimi) të përdorura në proceset e teknologjisë të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;

- Të realizojë proceset e përgatitjes së lëndëve të para dhe atyre ndihmëse (shitesa, ujë, kimikate, etj.) për teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të zbatojë kartën teknologjike të proceseve të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të kontrollojë parametrat e punës që ndikojnë në proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të realizojë kontrollin cilësor të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme gjatë proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë aparatet e matjes dhe të kontrollit të parametrave të punës gjatë proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë aparatet e pastrimit të gazeve dhe ajrit nga pluhurat, bloza dhe avujt toksikë (tretësa organikë, squfuri, kimikate, lëndët avulluese, etj.);
- Të hartojë bilanc të thjeshtë material të proceseve teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të kryejë përgatitjen e “masës punuese” në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të zbatojë recepturat e lëndëve të para dhe shitesave në proceset e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të realizojë procesin e copëtimit, thërrmimit dhe bluarjes së materialeve të ngurtë (të plastikës dhe gomës);
- Të vlerësojë rolin e thërrmimit dhe imtësisë së bluarjes së lëndëve të para dhe atyre ndihmëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të zbatojë kërkesat kryesore teknike dhe teknologjike për sigurimin, transportimin, depozitimin, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e lëndëve të para, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë mjetet, pajisjet, makineritë, linjat teknologjike, armaturat dhe aparaturat e infrastrukturës të transportit, depozitimit, ruajtjes, tregimit të gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të interpretojë rolin e ambalazheve dhe etiketimit në industrinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë njësitë matëse në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
- Të krahasojë treguesit cilësor të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse, të gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës me standardet përkatëse;
- Të përdorë aparatet për përcaktimin e treguesve cilësorë të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse, të gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
- Të zbatojë standardet kryesore për treguesit cilësorë të plastikës dhe gomës;

- Të interpretojë rezultatet e analizave fiziko-mekanike dhe kimike të lëndëve të para, lëndëve ndihmëse, të gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të teknologjisë së prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të zbatojë masat kryesore për të parandaluar, mbrojtur dhe luftuar korrozionin në pajisjet, makineritë, linjat dhe aparaturat në proceset e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të interpretojë shkaqet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në prishjen e cilësisë, gjatë prodhimit, përpunimit, riciklimit, transportimit, depozitimit dhe ruajtjes së produkteve të gatshme;
 - Të analizojë humbjet, faktorët dhe masat për minimizimin e tyre gjatë proceseve të prodhimit, përpunimit, riciklimit, transportimit, depozitimit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorimit të lëndëve të para, gjysmë produkteve dhe produkteve të gatshme të plastikës dhe gomës;
 - Të dallojë defektet dhe anomalitë kryesore të mundshme që mund të ndodhin në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të zbatojë masat për parandalimin dhe eliminimin e defekteve dhe avarive kryesore në proceset teknologjike të prodhimit, përpunimit dhe riciklimit;
 - Të përdorë simbolet për leximin e skemave të proceseve të prodhimit, përpunimit /riciklimit;
 - Të lexojë skica dhe vizatime të thjeshta të prodhimeve nga teknologjia e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomave;
 - Të kryejë matje gjeometrike të produkteve të fituara të plastikës dhe gomës;
- ❖
- Të vlerësojë rolin e përdorimit të ujit industrial në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të dallojë treguesit kryesorë të ujit që përdoret në teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të realizojë trajtimin e ujërave në përshtatje me kërkesat e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;
 - Të përdorë pajisjet, aparaturat dhe skemat teknologjike kryesore të trajtimit të ujit për teknologjinë e prodhimit, përpunimit dhe riciklimit të plastikës dhe gomës;

Prodhimi, përpunimi dhe riciklimi i gomave

- Të dallojë llojet e kauçukut si lëndë e parë (kauçuku natyral-lateksi dhe kauçuku sintetik), në industrinë e gomës;
- Të dallojë vetitë fiziko - kimike dhe mekanike të kauçukut;
- Të dallojë vetitë dhe karakteristikat e lëndëve ndihmëse (vullkanizuese, shpejtuese, aktivizuese, frenuese, mbushëse, pigmentet, zbutëse, kundër vjetërimit, speciale, etj.);
- Të interpretojë vartësinë e plasticitetit nga temperatura;
- Të kryejë proceset e regjenerimit të gomës së vjetër me kauçuk natyral;
- Të kryejë procesin e prodhimit të regjeneratës me metoda kimike, me avull dhe mekanike;
- Të kryejë procesin e përpunimit, homogjenizimit dhe rafinimit të regjeneratës;

- Të dallojë llojet e tekstileve, rëndësinë dhe përdorimin që kanë në industrinë e gomës;
- Të zbatojë recepturat e lëndëve të para, ndihmëse dhe adezivëve për prodhimin e brumit, sipas llojit të gomës;
- Të dallojë stadet e proceseve teknologjike kryesore të përgatitjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e gomave;
- Të realizojë procesin teknologjik të përzierjes së kauçukut dhe lëndëve të para të gomës;
- Të realizojë procesin teknologjik të përpunimit të brumërave të gomës dhe tekstileve për prodhimin e gjysmë produkteve të gomës;
- Të realizojë procesin e vullkanizimit të gomës;
- Të interpretojë ndryshimin e vetive fiziko-kimike dhe mekanike që ndodhin, gjatë procesit të vullkanizimit;
- Të realizojë metodat e vullkanizimit me ajër të nxehtë dhe avull, me rrjedhje dhe formësim me presim me rrjedhje, transferues dhe me injektim;
- Të përdorë presat hidraulike;
- Të kontrollojë parametrat teknologjikë gjatë procesit të vullkanizimit;
- Të dallojë llojet e gomave sipas fushave të përdorimit të tyre;
- Të zbatojë metodat e prodhimit të artikujve prej gome (derdhje- me presim, transferim dhe injektim; ekstrudim; kalandrim; veshje dhe shkumim);
- Të kryejë matje të parametrave të punës (temperatura, shtypja etj.) gjatë proceseve teknologjike për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e gomave;
- Të interpretojë karakteristikat cilësore fiziko-kimike dhe fiziko-mekanike të gomës dhe artikujve të saj;

Riciklimi i gomave të përdorura

- Të identifikojë burimet e mbetjeve të gomave të përdorura dhe karakteristikat për riciklim;
- Të përdorë metodat e trajtimit (riciklimit-riveshje, incinerimit, pirolizës, bluarje etj.) të gomave të përdorura;
- Të kryejë proceset teknologjike të riciklimit (riveshjes) të gomave të përdorura;
- Të kryejë proceset teknologjike të incinerimit të gomave të përdorura;
- Të kryejë proceset teknologjike të pirolizës të gomave të përdorura;
- Të dallojë fazat e procesit të riciklimit (riveshjes) dhe të grimcimit të gomave të përdorura;
- Të realizojë proceset e grimcimit mekanik, hidraulik me ujë me presion dhe me sitë në temperatura të larta, të gomave të përdorura;
- Të kryejë procesin e grumbullimit dhe seleksionimit të gomave të përdorura;
- Të kryejë procesin e copëtimit dhe thërrmimit të gomave të përdorura për shtresë për rrugica dhe asfalt gome;
- Të kryejë procesin e shformësimit të gomave të përdorura, etj.;

Prodhimi, përpunimi dhe riciklimi i masave plastike

- Të përzgjedhë lëndët e para dhe lëndët ndihmëse për prodhimin e masave plastike;

- Të realizojë ndarjen në grupe të lëndëve ndihmëse (zbutëse, mbushëse, stabilizuese, ngjyruese, për pigmente, për lubrifikim, etj.) sipas vetive, karakteristikave dhe rëndësisë së përdorimit të tyre në industrinë e plastikës;
- Të zbatojë recepturat e lëndëve të para, ndihmëse dhe adezivëve për prodhimin e brumit, sipas llojit të masave plastike;
- Të dallojë llojet e makinerive, aparateve dhe pajisjeve kryesore për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e masave plastike, duke shpjeguar funksionin e tyre;
- Të zbatojë statet e proceseve teknologjike kryesore të përgatitjes së lëndëve të para dhe ndihmëse për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e masave plastike;
- Të kryejë procesin teknologjik të copëtimit, thërrmimit, granulimit, përzierjes dhe presimit;
- Të kryejë përpunimin e lëndëve të para për prodhimin e masave plastike me derdhje, me presim, me injektim, me tërheqje ose ekstrudim, me petëzim (laminim), kalandrim, me veshje;
- Të kryejë matje të parametrave të punës (temperatura, shtypja etj.) gjatë proceseve teknologjike për prodhimin, përpunimin dhe riciklimin e plastikës;
- Të krahasojë treguesit cilësorë, fiziko-kimike dhe fiziko-mekanike të plastikës dhe artikujve të saj me treguesit sipas standardeve përkatëse;
- Të kryejë matjen dhe shënimin e sipërfaqes së masave plastike me anë të veglave ose shablloneve;
- Të realizojë veprimet kryesore për përpunimin mekanik të masave plastike;
- Të përzgjedhë veglat e punës për përpunimin e sipërfaqeve të masave plastike;
- Të realizojë procesin e sharrimit, shpimit, lëmimit, grirjes të masave plastike;
- Të dallojë llojet e presave për përpunimin e masave plastike;
- Të kryejë spërkatjen për përpunimin e masave plastike;
- Të zbatojë mënyrat e staxhionimit të materialeve plastike në hapësirën e depos;

Trajtimi i mbetjeve plastike

- Të identifikojë burimet e mbetjeve plastike dhe karakteristikat për ripërdorim, riciklim dhe trajtim kimikë;
- Të zbatojë metodat dhe teknikat e identifikimit të materialeve plastike në mbetje;
- Të zbatojë metodat dhe teknikat e identifikimit të llojeve të materialeve plastike në përzierje;
- Të zbatojë metodat e trajtimit të mbetjeve plastike;
- Të kryejë proceset teknologjike të riciklimit dhe të ripërdorimit të mbetjeve plastike;
- Të kryejë proceset teknologjike të përpunimit kimikë (piroliza, hidrogjenim, gazifikim dhe djegie) të mbetjeve plastike;
- Të përdorë pajisjet, makineritë, aparatet e matjes dhe kontrollit, linjat dhe armaturat sipas metodave të përpunimit të mbetjeve plastike.
- Të zbatojë hapat e procesit të riciklimit të mbetjeve plastike;

- Të realizojë procesin e grumbullimit, seleksionimit, copëtimit, larjes dhe tharjes të mbetjeve plastike;
- Të kryejë procesin e shkrirjes (në makina shkrirëse) dhe granulimit të mbetjeve plastike;
- Të kryejë procesin e shkrirjes (në Eskruderë) për kalim nga lëndë e parë (granulat) në stampa të formave të ndryshme, sipas llojit të artikullit të kërkuar;
- Të kryejë procesin e stampimit, shënjimit dhe prerjes të produkteve të stampuara të plastikës së ricikluar;

Makinat aparatet dhe pajisjet në teknologjinë e plastikës dhe gomës

- Të përdorë makinat kryesore, aparatet, pajimet dhe veglat e punës në repartet e prodhimit të gomës dhe përpunimin e masave plastike;
- Të realizojë transportin e fluideve dhe llojet e makinerive të transportimit të tyre (pompave, kompresorëve, ventilatorëve);
- Të kryejë transportin e materialeve të ngurta me transportier të llojeve të ndryshme (shirita transportues, makina pneumatike, elevator, konvejer);
- Të kryejë proceset e bluarjes dhe tharjes së materialeve të ngurta;
- Të përdorë përzierësit (mikserë, kalandrave) për prodhimin e plastikës dhe gomës;
- Të realizojë procesin e tharjes së gjysmë produkteve të plastikës dhe gomës;
- Të dallojë llojet e makinave për thërrmimin dhe granulimin e materialeve të ngurta (kauçukut, granulave plastike, etj.);
- Të përdorë kalandrat për nxjerrjen e shtresave të plastikës dhe gomës;
- Të përdorë makinat e konfeksionimit të gjysmë prodhimeve;
- Të përdorë makinat vullkanizuese;
- Të përdorë presat (presa hidraulike, rrotulluese) sipas karakteristikave të tyre;
- Të përdorë makinat për prodhimin e gypave dhe rripave të transmisionit nga plastika dhe goma;
- Të përdorë autoklavat, rezervuarët e ujit, kaldajat për prodhimin e avullit;
- Të identifikojë mjediset dhe makinat tharëse sipas ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
- Të kryejë procesin e tharjes së pëlhurave teknike;
- Të përdorë instrumentet matëse të temperaturës, shtypjes dhe kohës gjatë procesit të tharjes, së gjysmë prodhimeve të plastikës dhe gomës;

Sipërmarrja

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;

- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënies të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari social-kulturore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;

- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.